VENDIM
Nr.254, datë 7.4.2005

PËR NJOHJEN USHTARAKËVE TË FORCAVE TË ARMATOSURA SI PERIUDHË SIGURIMI TË PERIUDHËS SË TRAJTIMIT FINANCIAR, SIPAS VENDIMIT NR.225, DATË 29.5.1992 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR TRAJTIMIN FINANCIAR TË USHTARAKËVE, QË DALIN NË LIRIM NGA ZBATIMI I REFORMËS NË STRUKTURAT E FORCAVE TË ARMATOSURA"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 58 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Periudha e përfitimit të trajtimit financiar nga ushtarakët e Forcave të Armatosura, në përputhje me vendimin nr.225, datë 29.5.1992 të Këshillit të Ministrave, të njihet, duke filluar nga data 1.10.1993 e në vazhdim, si periudhë sigurimi, për efekt pensioni pleqërie, invaliditeti dhe familjar.

2. Kontributet për këtë periudhë të llogariten mbi pagën mujore minimale dhe të përballohen nga Buxheti i Shtetit, duke filluar nga koha kur merret vendim për caktimin e pensionit të pleqërisë, të invaliditetit apo familjar dhe pasi të jetë përcaktuar periudha individuale, e nevojshme, si periudhë sigurimi për efekt pensioni pleqërie, invaliditeti a familjar.

3. Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Rendit Publik, Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit dhe Shërbimi Informativ i Shtetit, në bashkëpunim me Institutin e Sigurimeve Shoqërore, duke filluar nga viti 2006 e në vazhdim, të planifikojnë numrin e personave, që do të dalin në pension në vitin përkatës, si dhe fondet e nevojshme për kontributet e sigurimeve shoqërore.

4. Efektet financiare për vitin 2005 të përballohen nga buxheti i këtij viti, miratuar për Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

5. Institutit të Sigurimeve Shoqërore, nga Buxheti i Shtetit, t'i shtohet, çdo vit, shuma e nevojshme për këtë qëllim.

6. Ngarkohen Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale, Ministria e Financave, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Rendit Publik, Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit, Shërbimi Informativ i Shtetit dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano